



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.1095/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtar, si dhe me pjesmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Syla, duke vendosur përkritazi me ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Huluntuëse BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Mitrovicë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale të datës 19.11.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 21.11.2017, mori këtë:

#### V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Huluntuëse BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA me seli në Prishtinë, ashtu që subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Mitrovicë, i shqiptohet dënimi më gjobë në shumë prej 2,700.00 (dymjë e shtatqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

#### A r s y e t i m

Me datën 19.11.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Rrjetit Ballkanik për Gazetari Huluntuëse BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, me të cilën ka pretenduar se kandidati për anëtar të Kuvendit Komunal në Mitrovicë, Mirsad Ferati, nga radhët e subjektit politik PDK, ditën e zgjedhjeve, me datë 19.11.2017, në ora 12:24 pasdite, ka shpërndar një fotografi me mbishkrimin “69.89% Valdete Idrizi Forca e Ndryshimit PDK 94”. Më tej ka theksuar se këto veprime bien ndesh me nenin 36.1 pika b) të LZP-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara në cilësi të provës materiale.

Subjekti politik PDK në përgjigje në ankesë të datës 21.11.2017, ka theksuar se, ankesa është e pabazuar për faktin se fotoja e publikuar në rrjetin social facebook nga kandidati për anëtar të Kuvendit Komunal në Mitrovicë, Mirsad Ferati nuk nënkupton thirrje për votim përpos gjoja një prognozë të tij personale e shprehur në përqindje. Më tej ka theksuar se PDK, nuk mund të kontrollojë qindra e mijra votues për postimet e tyre.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën dhe provat që gjenden në shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 të LZP-së gjeti se:

### **Ankesa është e bazuar**

Nga fotografia e ofruar si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se kandidati për anëtar të Kuvendit Komunal në Mitrovicë, Mirsad Ferati, nga radhët e subjektit politik PDK, ditën e zgjedhjeve, gjatë heshtjes zgjedhore në rrjetin e tij social facebook ka shpërndarë fotografimin e kandidatës për kryetare të Kuvendit Komunal në Mitrovicë Valdete Idrizi, nga radhët e subjektit politik PDK me mbishkrimin “69.89% Valdete Idrizi Forca e Ndryshimit PDK 94”, ku me këtë veprim ka shkelur Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit dhe Kandidatet e tyre duke bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore.

Pretendimet e subjektit politik PDK se fotoja e publikuar në rrjetin social facebook, nga kandidati për anëtar të Kuvendit Komunal në Mitrovicë, Mirsad Ferati nuk nënkupton thirrje për votim përpos një prognozë të tij personale e shprehur në përqindje, këto pretendime nuk janë të bazuara për faktin se mënyra se si është formuluar postimi PDK me mbishkrimin “69.89% Valdete Idrizi Forca e Ndryshimit PDK 94”, paraqet promovim të kandidatit gjatë kohëzgjatjes së heshtjes zgjedhore.

Pretendimi i subjektit politik PDK, se nuk mund të kontrolloj qindra mijra votues, nuk qëndron për faktin se shkelësi Mirsad Ferati, se i njëjti është kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Mitrovicë nga radhët e subjektit politik PDK, ndërsa neni 32.3 i LZP-së i përcakton se “subjektet politike i informojnë në mënyrë të duhur anëtarët mbështetësit dhe kandidatët e tyre rreth dispozitave të këtij Kodi”

Andaj, PZAP-i duke marrë parasysh shkeljet e gjetura, bazuar në nenin 36 të LZP-së, që përcakton veprimet e ndaluara para procesit të votimit ku parashihet se 24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja fushatë në çfarëdo mënyre, andaj subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), është përgjegjëse për shkeljet e gjetura të thyerjes së heshtjes zgjedhore në bazë të nenit 32.5 të LZP-së ku përcaktohet se “subjektet politike mbahen përgjegjëse për shkeljet e këtij Kodi të kryera nga anëtarët mbështetësit e tyre”.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat për rastet: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjektit politik në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin se PDK-ja, ka qenë e njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore si dhe shumën e fondeve që ka marra subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve lidhur me fushatën zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i, mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjet e tij ka mohuar shkeljet e supozuara dhe e njëjta nuk ka ofruar prova sipas nenit 32.6 të LZP-së.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

ZL Anr.1095/2017 më datë 21.11.2017



**Kryesuesi i Panelit**  
**Hasan Shala**

**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*